



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



DATË/A	27.06.2025
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Kryeshefat Ekzekutiv te KRU-ve
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hajrije Morina, Drejtoreshë e ARRU
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përcaktimet e tarifave 2026 - 2028



Të nderuar,

Ne konfirmojmë se ju jeni furnizuar me politikën, procedurat, modelin e tarifave dhe informacione të tjera mbështetëse të nevojshme për të përgatitur paraqitjen e planit tuaj të biznesit tarifor në WSRA deri më 31 gusht 2025. Ky afat duhet të përmbushet për të siguruar që tarifat e reja mund të miratohen më 1 janar 2025.

Para këtij afati, ne sjellim në vëmendjen tuaj disa fusha ku kërkojmë që ju të na përditësoni për progresin.

Tarifat fikse bazuar në madhësinë e lidhjes

Më datë 25.11.2024, ARRU ka dërguar një shkresë duke deklaruar se nga viti 2026 tarifat fikse do të bazohen në madhësinë e lidhjes. Kjo veçori tani është përfshirë në modelin e ri të përcaktimit të tarifave. Në shkresën tone, ARRU ju ka këshilluar që KRU-të duhet të bëjnë ndryshimet e nevojshme në sistemet e tyre të faturimit për të pranuar këtë ndryshim. Ju lutemi të na njoftoni për përparimin që keni bërë në këtë drejtim, ashtu që ARRU të jetë e sigurtë se ndryshimet në softuer janë kryer përpara se regjimi i ri i tarifave fikse të hyjë në fuqi më 1 janar 2026.

Tarifat e vlerësuara

Më datë 25.22.2024, ARRU ka dërguar një shkresë duke deklaruar se nga viti 2026, KRU-të duhet të identifikojnë konsumatorët specifikë jo-shtëpiakë tek të cilët gjenerimi i ujërave të ndotura nuk reflektonë volumin e ujit që furnizohet nga KRU, ashtu që faturat e tyre të bazohen në volumin real të ujërave të ndotura të gjeneruara prej këtyre konsumatorëve jo-shtëpiak. Kjo veçori tani është përfshirë në modelin e ri të përcaktimit të tarifave. Në shkresën tonë ne këshilluam KRU-të për të ndërmarrë hulumtime për të përcaktuar se sa konsumatorë, nëse ka të tillë, duhet përfshirë në këtë kategori për të përcaktuar rrjedhat e tyre përkatëse të ujërave të ndotura. Ju lutemi të na njoftoni për përparimin e bërë në këtë drejtim, ashtu që ARRU të jetë e sigurt se konsumatorë e tillë do të përfshihen në aplikimin për përcaktimin e tarifave.

Tarifat për effluentët që shkarkohen nga bizneset dhe industria

Më datë 25.11.2024, ARRU ka dërguar një shkresë duke deklaruar se nga viti 2026 KRU-ve u kërkohet të aplikojnë tarifa për konsumatorët biznes-industri që gjenerojnë ujëra të ndotura të një cilësie që është dukshëm e ndryshme nga cilësia mesatare e ujërave të ndotura, ose janë shumë më të ndotura ose dukshëm më pak të ndotura. Letra jonë edhe pse deklaronte që kjo ishte një kërkesë, ARRU ishte e hapur që KRU-ve individuale t'ju pranohet një kërkesë për përjashtim të aplikimit të kësaj kërkesë për përjashtim, me kusht që të ofrojnë dëshmi pse duhet të përjashtohen nga kjo kërkesë.

Ju lutemi keni parasysh që konsumatorët që janë subject I tarifave për effluentët e shkarkuar nga bizneset dhe industria ndahen në dy kategori: Kategoria 1 për konsumatorët e mëdhenj individualë ku tarifat janë specifike për lokacionin, dhe konsumatorët e Kategorisë 2, tarifat e të cilëve bazohen në llojin e biznesit, p.sh. restorantet, objektet e përpunimit të ushqimit dhe të tjera. Aplikimi/ kërkesa për përjashtim mund të përfshijnë Kategorinë 1, ose Kategorinë 2, ose të dyja. Çdo aplikim për përjashtim duhet të dorëzohet tek ARRU deri më 31 korrik 2025, për të na lejuar të marrim vendim për kërkesën tuaj, brenda afateve kohore deri në afatin e dorëzimit të aplikacioneve tarifore deri më 31 gushtit 2025.

Ne kërkojmë një përgjigje të shpejtë nga ana juaj ndaj kërkesave tona më lartë.

E juaja,

Hajrije Morina

Drejtor, ARRU